



COMUNE DI NONANTOLA
Centro Intercultura

Associazione
di promozione
sociale

giunchiglia11



illustrazione di Mirjana Farkas

Coronavirus: attenzione, non paura

Mirdita Nonantola,
ashtu si shumë qytete e krahina te Italisë së veriut po kalojnë një periudhë të veshtirë si pasojë e mundësisë që Koronavirusi mund të prek shumë njerëz. Nuk duhet të kemi frikë por në të njëjtën kohë duhet që të gjithë të kemi shumë kujdes. Për këtë janë të dobishme këshillat që ka publikuar këto ditë Ministria e Shëndetsisë. Këshilla që janë të rëndësishme për të mbrojtur shëndetin publik duke nisur nga më të dobëtit (të vjetrit dhe të sëmurët mbi të gjitha). **Shkolla Frisoun** e Nonantolës mendoj ti përkthente për të qënë të kuptueshme për pjesën më të madhe të njerëzve.

Ja dhe këshillat e higjenës të dhëna nga Ministria e Shëndetit:

- 1) Lani shpesh duart. Është e rëndësishme të vendosen në dispozicion të njerëzve në të gjithë ambientet publike (palestër, zyra publike, shoqate, kisha, xhami dhe ambiente kulturore...) sapun dhe produkte që përmbajnë solucione hidroalkolike për larjen e duarve.
- 2) Me edukatë dhe delikatese, mundohuni të mos i rrini shumë afër personave që vuajnë nga infeksione respiratore akute (bronkit, temperaturë, veshtirësi në aparatit respirator).
- 3) Mos prekni sytë, hundën dhe gojën me duar.
- 4) Mbuloni hundën dhe gojën nëse teshtini ose kolliteni (do ishte mirë me bryl).
- 5) Mos merrni ilaçe antivirale apo antibiotik nëse s'jua ka përcaktuar mjeku juaj.
- 6) Pastroni sipërfaqet me disinfektant me bazë klori ose alkoli.
- 7) Përdorni maskat nëse dyshoni se jeni i prekur ose ndihmoni njerëz që janë të prekur.

Traduzione in albanese di **Blerina Nushi**